



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	02.08.2022
REFERENC-Ë:	01-600/01-0073051/22
PËR/ZA/TO:	Zyra e Kryetarit të Komunës z. Bedri HAMZA - Kryetar
KOPJE :	Drejtorëve të Drejtorive
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorisë për Buxhet dhe Financa znj. Igballe ISLAMI - Drejtoreshë
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Buxhet dhe Financa z. Adem FAZLIU – Z.K.F.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për Dëgjimet Buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit të vitit 2023-2025

I nderuar kryetar,

Duke u bazuar në detyrimin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-48 në pajtim me kalendarin dhe procedurat e parapara me Qarkoren Buxhetore 2023/01 për Komunat, ju njoftojmë për zhvillimin e procesit buxhetor komunal.

Pas shqyrtimeve të kërkesave fillestare për planifikimin e KAB-it Komunal 2023 - 2025, jemi të obliguar t'i mbajmë dëgjimet publike buxhetore me qytetarë për Draft-buxhetin e vitit 2023 dhe parashikimet për 2024-2025, andaj ne si organizatë buxhetore edhe këtë proces të planifikimit buxhetor e kemi përmbyllur sipas një plani dinamik të veprimit dhe të njëjtin e kemi aprovuar, gjithnjë duke respektuar transparencën për planifikimin e buxhetit me pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e përgatitjes së buxhetit komunal.

Për përpilimin dhe planifikimin e buxhetit për vitet 2023 – 2025, duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, ne si organizatë buxhetore rekomandohe mi që të mbajmë tri dëgjime buxhetore, por duke pretenduar që planifikimi i buxhetit të jetë sa më transparent si dhe të mos anashkalohen kërkesat e qytetarëve dhe

grupeve të ndryshme të interesit, Komuna e Mitrovicës përkatësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka organizuar gjithsejt tetë (8) dëgjime buxhetore, duke përfshirë në këto dëgjime pothuajse të gjitha strukturat dhe grupet e qytetarëve të interesit në Komunën e Mitrovicës. Në këtë vit kemi vendosur që t'i organizojmë dëgjimet në dy modalitete, duke përfshirë takimet në teren - në fshatra, lagje dhe lokalitete me qytetarë dhe takimet tjera të mbajtura në Sallën e Kuvendit Komunal në Mitrovicë. Dëgjimet buxhetore kanë filluar me datën 20.07.2022 dhe kanë vazhduar deri më datë 28.07.2022.

Duke u bazuar në planin dinamik të mbajtjes së këtyre dëgjimeve buxhetore me qytetarë të grupeve të ndryshme të interesit, mund të konstatojmë se ekipi i caktuar për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore nuk ka patur mbështetje nga bartësit përkrrahës dhe përgjegjës të dëgjimeve buxhetore, përveq zyrës për informim, TV Mitrovicës dhe pjesërisht zyrës për barazi gjinore. Poashtu, kanë munguar njoftimet nga Sekretaria e Kuvendit për përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve dhe lokaliteteve për pjesëmarrje dhe senzibilizim të këtyre dëgjimeve buxhetore me qytetarë, sepse në takime nuk kanë prezentuar numër i pritur i qytetarëve. Përveq, drejtorit të Shëndetësisë, drejtoreshës së DKRS, u.d. i drejtorit të Teatrit, drejtoreshës së Mirqenies Sociale, drejtorit të Inspeksionit, drejtorit të QPS, në këtë proces nuk kemi pasur mbështetje nga asnjë drejtor tjetër dhe nga Zyra e Kuvendit, së paku kemi pritur pjesëmarrjen e tyre gjatë katër takimeve të fundit kur i kemi mbajtur në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Nga dëgjimet buxhetore me qytetarë kanë dalur një numër i madh i kërkesave të cilat, nësi drejtori i kemi trajtuar me kujdes të veçantë dhe kemi evidentuar secilën prej tyre. Të gjitha kërkesat të cilat kanë bazë dhe arsyeshmëri sipas mundësive financiare do të mundohemi që t'i inkorporojmë në planifikimin e buxhetit për vitin 2023-2025.

Falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit në dëgjime buxhetore duke filluar nga Kryetari, Drejtorët pjesëmarrës, Zyrtarët, Mjekët dhe personelin shëndetësor, Rininë, Klubet sportive, OJQ e shoqërisë civile, përfaqësuesit pjesëmarrës të lagjeve, fshatrave dhe lokaliteteve, fermerët, bujqit dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë.

Këshillat, kërkesat dhe opinionet e tyre janë sygjerime shumë me rëndësi në planifikimin e buxhetit për vitet e ardhshme.

Bashkëngjitur mund të gjeni :

- Raportin e dëgjimeve buxhetore për vitin 2023-2025;
- Orarin e dëgjimeve buxhetore.

Me respekt !

Nr	Përshkrimi	Bartësit e Aktivitetit
----	------------	------------------------

Dëgjimet Buxhetore janë mbajtur duke u bazuar në orarin e propozuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe të aprovuar nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës. Në dëgjimin e gjashtë buxhetor ka marrë pjesë Kryetari dhe disa nga drejtorët komunal. Në të gjitha Dëgjimet kanë marrë pjesë Drejtoresha për Buxhet dhe Financa me zyrtarët e Drejtorisë së njejtë. Vlen të ceket prania e zyrës së informimit në secilin dëgjim poashtu, Zyra për Informim ka publikuar orarin e dëgjimeve buxhetore dhe është kujdesur që pas çdo dëgjimi buxhetor të dalë me një komunikatë përshkruese në web-faqen zyrtare të Komunës.

Kërkesat e qytetarëve janë dhënë verbalisht po edhe janë shënuar në kartelat e dëgjimeve buxhetore të cilat janë shpërndarë në sallë. Kërkesat nuk janë prezentuar të gjitha në raport mirëpo janë selektuar dhe kërkesat e përsëritura nuk janë paraqitur.

ZKF-Adem FAZLIU, në çdo dëgjim buxhetor ka shpalosur draft-buxhetin komunal për vitin 2023-2025. Totali i buxhetit për komunën e Mitrovicës për vitin 2023 është 25,011,350.00 Euro ku granti i përgjithshëm për vitin 2023 për komunën e Mitrovicës do të jetë në shumën prej 9,725,479.00 euro, granti specifik për arsim 8,522,968.00 Euro, granti specifik i shëndetësisë 2,739,643.00 Euro, shërbimet rezidenciale 180,000.00 Euro dhe THV 3,673,370.00 Euro.

Dëgjimi i Parë Buxhetor në Shipol me qytetarë dhe përfaqësues të fshatrave dhe lagjeve për reth

<p>Ky dëgjim buxhetor është mbajtur me datën 20.07.2022 e mërkurë. Informimi paraprak për palët e interesuara është bërë më herët në web-faqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës. Gjithashtu edhe drejtoritë bartëse të aktivitetit janë njoftuar më herët dhe janë informuar rreth mënyrës së organizimit të Dëgjimeve Publike Buxhetore. Të pranishëm në dëgjim buxhetor ishin drejtoresha, Z.K.F. zyrtarët e drejtorisë për buxhet dhe financa, zyrtarja për barazi gjinore dhe zyrtarët e zyrës së informimit. Propozimet buxhetore nga të pranishmit ishin shumë domethënëse, por kryesisht ankoheshin për problemet e njëjta ose të përafërta. Më poshtë mund të gjeni të gjitha propozimet e shënuara në kartelat buxhetore nga ana e të pranishmëve.</p>	<p>Zyra e Kryetarit Drejtoria për Financa Zyra e Informimit TV Mitrovica Drejtorët e Drejtorive Zyra për Barazi Gjinore</p> <p>Pjesëmarrës : 16</p>
<p>I. - Zgjerimi i ambulants (laborator analizash, ordinancë specialistike, etj.); - Zyrja e Vendit të vendoset afër Qerdhës së fëmijëve; - Ndriçimi Publik; - Të rregullohet vija administrative ndërmjet Urës së Gjakut dhe Shipolit si dhe ndërmjet Shipolit dhe Zhabarit.</p>	<p>Salih Meha Përfaqësues i fshatit Shipol</p>

2.	<ul style="list-style-type: none"> - Planifikimi indërtimit të një Shtëpie për Pleq; - Ndërtimi i një hapësire sportive rekreative; - Përmirësimi i asfaltit me një shtresë shtesë; - Përmirësimi i trotuareve dhe përfundimi I investimeve (investimet e bëra janë të papërfunduara). 	<p><i>Ismet Syla</i></p> <p><i>Shipol</i></p>
3.	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi ose improvizimi i një qendre kulturore; - Ndarja e një parcele për një park për të moshuar; - Zgjerimi i ambulantes dhe zgjatja e orarit të punës së saj (24h); - Rregullimi i transportit publik; - Mbjellja e pemëve dhe gjelbërimit në hapësirat publike. 	<p><i>Shpresa Bajrami</i></p> <p><i>Shipol</i></p>
4.	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullimi i infrastrukturës së Fshatit Lushtë; - Asfaltimi i rrugicave të pa asfaltuara; - Rregullimi i ndriçimit të fshatit; - Vazhdimin e rregullimit të shtratit të lumit Lushtë; - Trotuarët dhe rrëzimin e shtëpive të vjetra. 	<p><i>Ramiz Sejdiu</i></p> <p><i>Përfaqësues i Fsh. Lushtë</i></p>
5.	<ul style="list-style-type: none"> - Largimi i kioskës afër ambullantës në Shipol (përballë ambulantës); - Të planifikohet një hapësirë për shfrytëzim për aktivitete rinore, sportive dhe kulturore; - Të ndërrohet lokacioni i shkollës së Zhabarit për shkak të rrezikut të fëmijëve nga komunikacioni në rrugën kryesore; - Të rregullohen trotuaret; - Pasrimi i oborrit të xhamisë tek varrezat nga mbeturinat e ndryshme. 	<p><i>Nuredin Nebihu</i></p> <p><i>Shipol</i></p>

6.	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullimi i rrugës së Shipolit, Ura e Gjakut, rregullimi i varrezave. - Të përmirësohet furnizimi me ujë të pijshëm; - Të rritet kapaciteti i ambulancës së Shipolit; - Të rregullohet qështja e qenëve endacak. 	<p>Fadil Imeri</p> <p>Shipol</p>
----	--	--

Dëgjimi i Dytë Buxhetor në Kçiq me qytetarë dhe përfaqësuesit e fshatit

	<p>Ky dëgjim buxhetor është mbajtur me datën 21.07.2022 (e enjte).</p> <p>Informimi paraprak për palët e interesuara është bërë më herët në web-faqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës. Gjithashtu edhe drejtoritë bartëse të aktivitetit janë njoftuar më herët dhe janë informuar rreth mënyrës së organizimit të Dëgjimeve Publike Buxhetore.</p> <p>Të pranishëm në dëgjim buxhetor ishin drejtoresha e DBF- Igballe ISLAMI, drejtori i D.Inspekcionit - Valon IBRAHIMI, Z.K.F. zyrtarët e drejtorisë për buxhet dhe financa dhe zyrtarët e zyrës së informimit. Propozimet buxhetore nga të pranishmit ishin shumë domethënëse, por kryesisht ankoheshin për problemet e njejta ose të për afërta. Më poshtë mund të gjeni disa nga propozimet kryesore të shënuara në kartelat buxhetore nga ana e të pranishmëve.</p> <p>Një falenderim të veçantë për organizim të pritjes në shkollën e fshatit e bëjmë për drejtoreshën e shkollës dhe banorëve të këtij fshati .</p>	<p>Zyra e Kryetarit</p> <p>Drejtoria për Financa</p> <p>Zyra e Informimit</p> <p>TV Mitrovica</p> <p>Drejtorët e Drejtorive</p> <p>Zyra për Barazi Gjinore</p> <p>Pjesëmarrës : 15</p>
1	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullimi i rrugës tek xhamija dhe rruga kryesore e fshatit; - Të rregullohet parkingu i shkollës; - Rregullimi i kanalizimit në lagjet që mungon; - Rruga kryesore e fshatit të emërtohet vetëm me një emër . 	<p>Elez Abazi</p> <p>Kçiq I Madh</p>

2	<ul style="list-style-type: none"> - Të riparohet rruga kryesore; - Të rregullohet parkingu i shkollës; - Rregullimi i kanalizimit në lagjet që mungon. 	<p>Asllan Shosholli Kçiq I Madh</p>
3	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i Çerdhës së fshatit; - Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës; - Kanalizimi në fshat të finalizohet (vetëm 20% e shtëpive janë të kyqura); - Rrugët dhe rrugicat e fshatit të ndërtohen (23 rrugica në fshat nevojiten të ndërtohen vetëm nga 30-90m); - Të ndërtohet një urë mbi Lumin Sitnica në drejtim të fsh. Pantinë (pasi që shumë fshatarë posedojnë tokë pjellore dhe ara matan L. Sitnica). 	<p>Fatmir Salihu Kryetar i Fsh. Kçiq i Madh</p>
4	<ul style="list-style-type: none"> - Të ndërtohet parking i shkollës; - Riparimi i asfaltit të dëmtuar; - Kompletimi i ndriqimit public; - Asfaltimi i disa rugicave ë mbetura; - Kompletimi i rrjetit të kanalizimit. 	<p>Besim Beka Kçiq I Madh</p>
5	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i troutarit nga rruga kryesore deri tek lagja e Shoshollëve; - Ndërtimi i Çerdhës për fëmi; - Të vazhdohet kanalizimi në vendet e mbetura; - Ndërimi i Shtëpisë së Kulturës. 	<p>Arsim Kamberi Kçiq I Madh</p>
6	<ul style="list-style-type: none"> -Rregullimi i rugës dhe kanalizimit – Rruga e Malit; - Ndriqimi i lagjës Hysenaj; - Ndërtimi i një ure mbi Lumin Sitnica; - Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës; - Ndërtimi i Pllakës përkujtuese të Martirëve të Luftës 1998-1999. 	<p>Halil Berisha Kçiq I Madh</p>

7	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i rrugës dhe kanalizimit në Rrugën e Malit; - Rregullimi i ndriqimit në Rrugën Sokol Brahim; - Ndërtimi i shtyllave elektrike në Rrugën Sokol Brahim; - Subvencionim në sektorinë e blektorisë dele, dhi, lopë; - Subvencionim me paisje bujqësore-makineri. 	<p>Besar Ibrahim</p> <p>Kçiq i Madh</p>
8	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i Rrugës Halil Pllana në drejtim të varrezave; - Rregullimi i trotuareve, ndriqimi publik; - Ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnicë; - Ndërtimi i një çerdheje; - Ndërtimi i Rrugës Behram Pllana. 	<p>Liridon Pllana</p> <p>Kçiq i Madh</p>
9	<ul style="list-style-type: none"> - Asfaltimi dhe ndriqimi i Rr. Çlirimtarët e Lirisë (400m); - Ndërtimi I fushës sportive në Rr. Çlirimtarët e Lirisë; - Asfaltimi i rrugës për aktivitete sportive në Fsh. Kçiq i Vogël tek pishat. 	<p>Alban Azemi</p> <p>Kçiq i Madh</p>

Dëgjimi i Tretë Buxhetor në Fshatin Gushavc me qytetarë dhe përfaqësuesit i fshatit

<p><i>Dëgjimi i tretë publik buxhetor është mbajtur në SHMU "Harun Beka"-Gushavc, dhe është udhëhequr nga drejtorja per Buxhet dhe Financa znj. Igballe Islami dhe ZKF z. Adem Fazliu, ndërsa kanë marrë marrë pjesë edhe zyrtarë nga DBF, Zyrtarja për Barazi Gjinore, zyrtarë nga Zyrja e Informimit, etj.</i></p> <p><i>Të pranishmit kanë paraqitur kërkesat e tyre gjatë këtij debati.</i></p>	<p>Zyra e Kryetarit</p> <p>Drejtoria për Financa</p> <p>Zyra e Informimit</p> <p>TV Mitrovica</p> <p>Drejtorët e Drejtorive</p> <p>Zyra për Barazi Gjinore</p> <p>Pjesëmarrës : 5</p>
---	--

1	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullimi i ujësjellësit në disa lagje të fshatit të cilët kanë problem me furnizim të ujit të pijshëm; - Rregullimi I kanalizimit; - Rregullimi I Rrugës së Shehrit; - Rregullimi I fshatit Gushavc; - Finalizimi I punëve të mbetura në shkollë e fshatit. 	<p>Skender Sahiti Kryetar i Fsh. Gushavc</p>
Dëgjimi i katërt Buxhetor në Fshatin Stan Tërg me qytetarë dhe përfaqësuesë të fshatit		
	<p>Në SHMU “Trepça”- Stan Tërg, është mbajtur dëgjimi i katërt me radhë buxhetor me qytetarë për Planifikimin e Buxhetit për vitin 2023-2025. Qëllimi i dëgjimit buxhetor ishte të identifikohen kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në mënyrë që planifikimi i buxhetit të jetë në përputhje me kërkesat e qytetarëve.</p>	<p>Zyra e Kryetarit Drejtoria për Financa Zyra e Informimit TV Mitrovica Drejtorët e Drejtorive Zyra për Barazi Gjinore Pjesëmarrës : 6</p>
1	<ul style="list-style-type: none"> - Të zgjidhet problemi me qenët endacak; - Rrugicat e fshatit të asfaltohen; - Të ketë mjek në ambulancën e fshatit. 	<p>Musa Ajeti Kryetar i Fshatit Stan Tërg</p>
2	<ul style="list-style-type: none"> -Rrugicat e fshatit të asfaltohet (1km); - Mjeku familjar të punoj 5 ditë të javës. 	<p>Fadil Zeneli Stan Tërg</p>
3	<ul style="list-style-type: none"> - Infrastruktura e fshatit të rregullohet; - Të ketë mjek në ambulancën e fshatit; - Të zgjidhet problemi me qenët endacak. 	<p>Shemsi Sadriu Stan Tërg</p>

Dëgjimi i pestë Buxhetor në Kuvendin Komunal me Arsimin Parafillor, Fillor dhe i Mesëm

	<p><i>Dëgjimi i pestë buxhetor është paraparë të mbahet me stafin arsimor të komunës. Njoftimi nga DKA për personelin arsimor për pjesëmarrje në këto dëgjime është bërë formalisht dhe ju është sygjyeruar që pjesëmarrja e tyre në këtë dëgjim të jetë sipas dëshirës.</i></p> <p><i>E gjithë kjo është bërë me ndërhyrjen e DKA-së në organizimin dhe mbajtjen e dëgjimit buxhetor, ku bartës kryesor ka qenë DBF dhe ZKF. Ndërsa bartës përgjegjës dhe përkrahës për organizimin e këtij dëgjimi ishte DKA. Andaj së paku kemi pritur që të prezantojnë në këtë takim Drejtoria e Arsimit dhe të na njoftojnë me rrjedhjen e dëgjimeve buxhetore interne që i kanë mbajtur me personelin arsimor si dhe të na i prezantojnë kërkesat që kanë dalur nga këto dëgjime dhe të jenë pjesë përbërëse e këtij raporti.</i></p>	<p>Zyra e Kryetarit Drejtoria për Financa Zyra e Informimit TV Mitrovica Drejtorët e Drejtorive Zyra për Barazi Gjinore Pjesëmarrës : 7</p>
1	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i hapësirave për mësimin praktikë (punëtorive, kabineteve, laboratorëve, etj.); - Ndërtimi i sallës së educates fizike; - Renovimi i objektit të shkollës në tërësi (izolimi i dritave, mureve, terasave, kulmit). 	<p>Sami Rama Drejtor i SHML "Arkitekt Sinani"</p>
2	<ul style="list-style-type: none"> -Asfaltimi i Rrugës Vigu; - Ndriqimi i rrugës kryesore; - Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore; - Asfaltimi i Rrugës Kroni; - Ndërtimi i nënkalimit të rrugës Vinarc-Koshtovë; - Vendosja e gypave të kanalizimit për Lagjen Imeri. 	<p>Lulzim Hasani Kryetar i Fsh. Vinarc i Epërm</p>
3	<ul style="list-style-type: none"> - Të rregullohet rrjeti I ujësjellësit dhe kanalizimit në lagjet: Hajdari, Sadiku dhe Sahiti; - Rregullimi dhe asfaltimi i Rrugës së Shehrit; - Ndriqimi i rrugor në fshat; - Ndërtimi i shtëpive të djegura gjatë luftës. 	<p>Skender Sahiti Kryetar i fshatit Gushave</p>

Dëgjimi i Gjashtë Buxhetor në Kuvendin Komunal - Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

	<p>Mbahet dëgjimi i gjashtë buxhetor me palët e interesit të sferës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale të qytetit të Mitrovicës për planifikimin e buxhetit për vitin 2023-2025.</p> <p>Në këtë takim ishin të pranishëm Kryetari i komunës, Bedri HAMZA, ZKF - Adem Fazliu. Drejtoresha për Buxhet dhe Financa -Igballe ISLAMI, drejtori për Shëndetësi- Fahri SHABANI, drejtoresha e DIEMS- Drita Ibrahimimi dhe drejtori I QPS-së Gani MUSTAFA.</p> <p>Kryetari Hamza ka shtuar se është rritur buxheti i DSH-së, është rritur furnizimi me barna esenciale, dhe në proces janë ndërtimi i katër ambulancave të mjekësisë familjare, ndërtimi i ambulancës në fshatin Koshtovë, si dhe është siguruar parcela për ndërtimin e ambulancës në Stan Terg.</p> <p>Ndërsa, ZKF ka shpalosur Draft-buxhetin 2023-2025.</p>	<p>Zyra e Kryetarit Drejtoria për Financa Zyra e Informimit TV Mitrovica Drejtorët e Drejtorive Zyra për Barazi Gjinore Pjesëmarrës : 20</p>
1	<ul style="list-style-type: none"> - Të rregullohet çatia e një pjese të QMF Zhabar dhe të gëlqerose pjesa e dëmtuar nga po e njejta; - Të rregullohet staza për të hendikepuar. 	<p>Nexharije Islami Pllana QMF Zhabar</p>
2	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkoj nga KK dhe DSH që parkingu I QKMF-së të bëhet me pagesë; - Kërkoj që në AMF-të Rashan, Bajgorë, Vllahi, etj. Të ketë doktor familjar së paku një herë në javë. 	<p>Agim Musa Zhabar</p>
3	<ul style="list-style-type: none"> - Fushatë veëdijësuse rreth informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre dhe institucionin ku mund të drejtohen në rast të padrejtësive ose ankesave që ata i kanë; - Monitorim, inspektim i punës së ambullantëve apo stafit të angazhuar nëpër këto ambullanta; - Rishiqim i kontratave për shërbime dhe monitorim më të madh nëse këto kompani janë duke i kryer shërbimet e tyre. 	<p>Nerimane Ferizi Rr. "Kosharës"</p>
4	<p>Kërkesat për Repartin e Laboratorit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Autoanalizator biokimik; - Autoanalizator imunologjik; - Mikroskop; - Frigorifer për ruajjen e reagjentëve. 	<p>Minire Zasella Rr. "Agim Ramadani"</p>

Dëgjimi i Shtatë Buxhetor në Kuvendin Komunal me përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve dhe lokaliteteve

	<p><i>Ky dëgjim buxhetor është mbajtur me datën 27.07.2022 (e mërkure)</i></p> <p><i>Dëgjimi i shtatë u mbajtë me përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve dhe lokaliteteve. Këtë takim e udhëheqi ZKF Adem Fazliu.</i></p> <p><i>Në këtë takim u diskutua kryesisht për identifikimin e kërkesave për planifikimin e buxhetit të vitit 2023. Gjatë debatit qytetaret kanë bërë propozime dhe kërkesa konkrete për nevojat në investime qoftë në infrastrukturë apo edhe në subvencionime të cilat do të përfshihen në projeksione fillestare të investimeve kapitale në kornizën afatmesme buxhetore 2023 - 2025.</i></p>	<p>Zyra e Kryetarit</p> <p>Drejtoria për Financa</p> <p>Zyra e Informimit</p> <p>TV Mitrovica</p> <p>Drejtorët e Drejtorive</p> <p>Zyra për Barazi Gjinore</p> <p>Pjesëmarrës : 9</p>
1	-Asfaltimi i rrugës së fshatit “Lulzim dhe Bedri Baliu”.	Xhelazim Baliu Kryetar i Fsh. Koprivë
2	-Asfaltimi i rrugës së Lagjes Resul, gjatësia e rrugës 1.6 KM.	Qazim Azemi Fshati Broboniq
3	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullimi i infrastrukturës së Fsh. Lushtë; - Asfaltimi i rrugicave të mbetura; - Ndriqimi i fshatit; - Subvencionim në bujqësi dhe punësim; - Ndërtimi i një fushe të vogël basketbolli; - Ndërtimi i troutarëve, vazhdimin e rregullimit të shtratit të Lumit Lushtë; - Rrëzimin e shtëpive ë vjetra që paraqesin rrezik për banorët, e në veqanti fëmijët. 	Ramiz Sejdiu Rr. Ujësjellësi – Fsh. Lushtë
4	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i rrugës së së dëmtuar Stanterg - Rrahovë; - Të punësohen gjeolog të rinj. 	Xhemail Peci Kryetar i Fsh. Rrahovë
5	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullimi i rrugëve mbrenda fshatit; - Ndërhyrje në rregullimin e disa dritarëve në ambulancën mjekësore të fshatit; - Më shumë subvencione në mekanizëm bujqësi, bletari; 	Xhevdet Zeneli Kryetar i Fsh. Selac

	<ul style="list-style-type: none"> -Përkujdesje për fëmijët me kushte të rënda ekonomike; - Ndërtimi I një fushe sportive në fshat. 	
6	<ul style="list-style-type: none"> - Ndriçimi public në Fshatin Zhabar; - Rregullimi I Rr.Sinan Sadiku dhe disa rrugicave tjera ; - Rregullimi I kanalizimit në disa lagje, në mes të fshatit; - Vendosja e policëce të shtrirë në rrugë. 	<p>Arben Sefedini</p> <p>Përfaqësues i Fsh.</p> <p>Zhabar i Epërm</p>
7	<ul style="list-style-type: none"> - Problem me qen endacak; - Asfaltimi i rrugicave në lagjen e Kolonisë; - Ndërtimi i rrethojës mbrojtëse në oborin e shkollës. 	<p>Musa Ajeti</p> <p>Kryetar i</p> <p>Fsh. Stan tërg</p>

Dëgjimi i Tetë Buxhetor në Kuvendin Komunal me qytetarë dhe palët e interesit në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit

	<p>Mbahet dëgjimi i tetë buxhetor për palët e interesit në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit të qytetit të Mitrovicës.</p> <p>Drejtorja për Buxhet dhe Financa, ka mbajtur dëgjimin e tetë publik me qytetarët për planifikimin e buxhetit për vitin 2023-2025.</p> <p>Në këtë takim ishin të pranishëm, drejtoresha e DBF Igballe ISLAMI, drejtoresha e DKRS Valdete IDRIZI,UD. i drejtorit të Teatrit të qytetit-Sabit Sheremeti, zyrtari kryesor financiar Adem Fazliu si dhe zyrtarë të tjerë komunal nga DBF.</p> <p>ZKF Adem FAZLIU tha se qëllimi i këtyre dëgjimeve është që të bashkë bisedojmë me qytetarët për të bërë një buxhet më të mirë që është në interes të qytetarëve. Gjithashtu ka sqaruar të pranishmëve se ky planifikim është bërë në fillim të këtij viti për aktivitetet e përgatitjes së Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore që paraja publike të adresohet aty ku është më e nevojshme. Totali i buxhetit për komunën e Mitrovicës për vitin 2023 është 25,011,350.00 Euro ku granti i përgjithshëm për vitin 2023 për komunën e Mitrovicës do të jetë në shumën prej 9,725,479.00 euro, granti specifik për arsim 8,522,968.00 euro”, granti specifik i shëndetësisë 2,739,643.00 Euro, shërbimet rezidenciale 180,000.00 Euro dhe THV 3,673,370.00 Euro, tha ndër të tjerash zyrtari kryesor financiar Adem Fazliu.</p>	<p>Zyra e Kryetarit</p> <p>Drejtorja për Financa</p> <p>Zyra e Informimit</p> <p>TV Mitrovica</p> <p>Drejtorët e Drejtorive</p> <p>Zyra për Barazi Gjinore</p> <p>Pjesëmarrës : 7</p>
1	<p>- Investim në punën vullnetare të të rinjët;</p> <p>- Më shumë aktivitete recreative për të rininë e qytetit.</p>	<p>Diellza HAZIRI Mitrovicë</p>
2	<p>-Përkrahje në projekte për OJQ</p>	<p>Gjyla HAJZERI OJQ “Zëri i Prindërve”</p>
3	<p>- Inicimi I themelimit të klubit të shahut në nivel komunal;</p> <p>- Organizim festiv dhe motivim për rezultatet e treguara në sport.</p>	<p>Vehbi GOXHULI Mitrovicë</p>
4	<p>-Përkrahje e grave dhe vajzave të reja fushën e ndërmarrësisë.</p>	<p>Melihat BESHIRI Mitrovicë</p>
5	<p>- Menaxhimi dhe trajtimi i mbeturinave urbane dhe rurale në komunën e Mitrovicës, Vushtrri dhe Skenderaj. Ky project mund të realyohet në bashkëpunim me kompani ndërkombëtare.</p>	<p>Asllan VITAKU Mitrovicë</p>
6	<p>- Krijimi i Qendrës për ndërmarrësi, karrierë dhe inovacion;</p> <p>- Të krijohen hapësira për të rinjët ndërmarrës.</p>	<p>Valbone SADIKU Mitrovicë</p>


7	<ul style="list-style-type: none"> - Paisje, projector dhe kushte më të mira për Qendrën e Kulturës dhe Teatrin e Qytetit; - Renovimi i objekteve ekzistuese (tjera) të kulturës; - Bashkëpunim (financim) më i gjërë me organizata, individ të tjerë rreth organizimeve në qytetin e Mitrovicës. 	Nerimane FERIZI Mitrovicë
8	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i peshkimit sportiv; - Identifikimi i ndotësve të ujërave; - Ndalimi i nxjerrjes së zhavorit nga Ibri dhe Sitnica. 	Arif KADRIU SHSPR IBRI
9	<ul style="list-style-type: none"> -Mbështetje e klubeve sportive për persona me aftësi të kufizuara, pasi që tani më jemi pranuar edhe ndërkombtarisht; -Paisje për sportet e personave me aftësi të kufizuara. 	Luan ÇABRA Mitrovicë
10	<ul style="list-style-type: none"> - Projekt për mirëmbajtje dhe shpenzime të zyrës; - Projekt sportiv për persona me aftësi të kufizuara; - Projekt për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara-Konventa 10 nentor 199; - 3 dhjetori dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara. 	Avni KELMENDI OJQ-Organizata e prindërve të fëmijëve dhe aftësi të kufizuara OPFA KOS- Mitrovicë
11	-GREEN FEST si festivali i vetëm në Mitrovicë ta ketë linjën e veçantë buxhetore nga Komuna e Mkitrovicës e jo të subvencionohet nga DKRS, shembuj të njejtë e ka Komuna e Pejës me ‘‘ANIBAR’’ dhe Komuna e Prizrenit me ‘‘ DOKUFEST’’.	Rinor KURSHUMLIU Mitrovicë
12	-Salla për stërvitje dhe RINGU për boks.	Nimon FEKA Mitrovicë K. Box. Trepça

13	<ul style="list-style-type: none"> - Lokacion adekuat për stërvitje të boksit; - Ringu; - Paisje (dorëza boksi). 	<p><i>Sefedin BRAHA Mitrovicë</i></p>
14	<ul style="list-style-type: none"> - Të ndërtohet një fushë volejboli afër Liqenit Arificial dhe tek OMNI SPORT; - Të lejohen 2-3 termine në javë falas për klubin tonë në objektin e OMNI SPORT; - Të mirret parasysh barazia gjinore tek subvencionimet në sport. 	<p><i>Pakize KOSOVA Mitrovicë Kv-femrat ‘‘ Trepça’’</i></p>



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica - Municipality of South Mitrovica

ORARI I DËGJIMEVE BUXHETORE ME QYTETARË PËR PLANIFIKIM TË BUXHETIT PËR VITET 2023 - 2025

Nr	Dëgjimet Publike 2022	Vendi, Data, Koha	Bartësit përgjegjës të dëgjimit	Bartësit përkrahës të dëgjimit buxhetor	Bartësit përgjegjës për njoftim dhe vendim e mbajtjes së dëgjimit buxhetor
1.	<u>Dëgjimi i Parë Publik me Qytetarë</u>	Shipol Sh.F "Fazli Grajçevci" Datë: 20.07.2022 – E mërkur Ora: 14:00	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Zyra e Kryetarit; Anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, TV Mitrovica; Drejtorët e Drejtorive; Zyra për Barazi Gjinore;	Me kërkesë të DKA – së obligohet Drejtoria e Shkollës që të bënë përgatitjen e vendit/hapsirës ku do të mbahet dëgjimi. Pjesëmarrës duhet të jenë edhe këshillat e fshatrave.
2.	<u>Dëgjimi i Dytë Publik me Qytetarë</u>	Kçiq Sh.F "Bislim Imeri" Datë: 21.07.2022 – E enjte Ora: 14:00	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Zyra e Kryetarit; Anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, TV Mitrovica; Drejtorët e Drejtorive; Zyra për Barazi Gjinore;	Me kërkesë të DKA – së obligohet Drejtoria e Shkollës që të bënë përgatitjen e vendit/hapsirës ku do të mbahet dëgjimi. Pjesëmarrës duhet të jenë edhe këshillat e fshatrave.

3.	Dëgjimi i Tretë <u>Publik me Qytetarë</u>	Gushavc Sh.F "Harun Beka" Data: 22.07.2022 – E premte Ora: 14:00	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Zyra e Kryetarit; Anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, TV Mitrovica; Drejtorët e Drejtorive; Zyra për Barazi Gjinore;	Me kërkesë të DKA – së obligohet Drejtoria e Shkollës që të bënë përgatitjen e vendit/hapsirës ku do të mbahet dëgjimi. Pjsëmarrës duhet të jenë edhe këshillat e fshatrave.
4.	Dëgjimi i Katërt <u>Publik me Qytetarë</u>	Stan Tërg Sh.F "Trepça" Data: 23.07.2022 – E shtunë Ora: 14:00	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Zyra e Kryetarit; Anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, TV Mitrovica; Drejtorët e Drejtorive; Zyra për Barazi Gjinore;	Me kërkesë të DKA – së obligohet Drejtoria e Shkollës që të bënë përgatitjen e vendit/hapsirës ku do të mbahet dëgjimi. Pjsëmarrës duhet të jenë edhe këshillat e fshatrave.
5.	Dëgjimi i Pestë <u>Publik me Qytetarë</u>	Komuna e Mitrovicës Salla e Kuvendit Data: 25.07.2022 – E hënë Ora: 14:00	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Zyra e Kryetarit; Anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, TV Mitrovica; Drejtorët e Drejtorive; Zyra për Barazi Gjinore	Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që të njoftojë për pjesëmarrje personelin e arsimor. Nivelin Parafillor, Fillor dhe të Mesëm.
6.	Dëgjimi i Gjashtë <u>Publik me Qytetarë</u>	Komuna e Mitrovicës Salla e Kuvendit Data: 26.07.2022 – E martë Ora: 14:00	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Zyra e Kryetarit; Anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, TV Mitrovica; Drejtorët e Drejtorive; Zyra për Barazi Gjinore	Obligohet Drejtoria Komunale e Shëndetësisë që të njoftojë për pjesëmarrje personelin e shëndetësisë primare dhe administrative. Pjsëmarrës do të jetë edhe Mirëqenja Sociale
7.	Dëgjimi i Shtatë <u>Publik me Qytetarë</u>	Komuna e Mitrovicës Salla e Kuvendit Data: 27.07.2022 – E mërkurë Ora: 14:00	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Zyra e Kryetarit; Anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, TV Mitrovica; Drejtorët e Drejtorive; Zyra për Barazi Gjinore	Obligohet Sekretaria e Kuvendit që të njoftojë për pjesëmarrje të gjithë përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve dhe lokaliteteve.

8.	<u>Dëgjimi i Tetë Publik</u> <u>me Qytetarë</u>	Komuna e Mitrovicës Salla e Kuvendit Data: 28.07.2022 – E enjtë Ora: 14:00	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Zyra e Kryetarit; Anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, TV Mitrovica; Drejtorët e Drejtorive; Zyra për Barazi Gjinore	Obligohet Drejtoria Kulturë, Rini e Sport që të njoftojë për pjesëmarrje përfaqësuesit e klubeve sportive, OJQ, Shoqëri të Civile dhe Minoritetet
----	--	--	--	--	--

Drejtorja për Buxhet dhe Financa

Igballe Islami
 Igballe ISLAMI

Zyrtari Kështesor Financiar



Adem Fazliu
 Adem FAZLIU

